
MEKANIZMI I AKIMIT AFTËSISA E KUFIZUAR

11 JANAR 2021

Observatori për të Drejtat e
Fëmijëve dhe të Rinjve
www.observator.org.al



Përmbajtja

Lista e shkurtimeve	3
Kushtet për zhvillimin e procedurës së ankimit	4
Si mund të vepohet në rast të shkeljes së të drejtave nga veprimi apo mosveprimi i organeve publike (KSHVAK)?	4
Çfarë forme dhe përmbajtjeje duhet të ketë ankimi administrative?	4
Cilat janë kushtet për pranimin e ankimit administrativ kundër një akti administrativ?	5
Afati kohor brenda të cilit duhet kryer ankimi	5
Procedura e ankimit dhe efektet e saj	6
Kujt organi mund t'i drejtohet ankimi?	6
Cila është procedura e shqyrtimit të ankimit?	6
Brenda cilit afat duhet të njoftohet akti që vendos mbi ankimin?	7
Efektet e ankimit	7
Cilat janë efektet e ankimit administrativ kundër një akti administrativ?	7
Kundërshtimi Administrativ	7
Çfarë mund të kërkohet me kundërshtimin administrativ të një veprimi të organit publik?	7
Brenda cilit afat duhet të paraqitet kundërshtimi administrativ?	8
Çfarë forme dhe përmbajtjeje duhet të ketë kundërshtimi administrativ i një veprimi të organit publik?	8
Brenda cilit afat duhet t'i njoftohet ankuesit vendimi i shqyrtimit të kundërshtimit administrativ?	8
Rishikimi	8
Çfarë është rishikimi dhe kur mund të kërkohet ai?	8
Cili është afati brenda të cilit duhet të paraqitet kërkesa për rishikim?	8
Ku dorëzohet kërkesa për rishikim?	9
Cili është vendimi që merret për rishikimin?	9
Ankimi në Gjykatë	9
Kur t'i drejtohem Gjykatës Administrative?	9
Si ngrihet një padi në Gjykatën Administrative?	9
Afati për ngritjen e padisë në gjykatë	10
Cilat janë afatet për ngritjen e padisë në gjykatën administrative?	10
A mund të ankimohet vendimi i gjykatës administrative të rrethit gjyqësor (të shkallës së parë).....	10
Strukturat e ankimit në Shërbimin Social Shtetëror	11

Lista e shkurtimeve

MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
DRSHSSH	Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror
DPSHSSH	Drejtoria Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror
KSHVAK	Komisioni Shumëdisiplinor I Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar

Kushtet për zhvillimin e procedurës së ankimit

Si mund të vepohet në rast të shkeljes së të drejtave nga veprimi apo mosveprimi i organeve publike (KSHVAK)?

Në raste të tilla mund të vepohet si më poshtë:

- Kryhet një ankim administrativ, i cili përfshin:
 - o Ankimin administrativ ndaj aktit administrativ (vendimit të KSHVAK) ose mosveprimit të organit publik për nxjerrjen e aktit brenda afatit të parashikuar (mosmarrja e vendimit në afat); ose,
 - o Kundërshtimin administrativ ndaj një veprimi tjetër të organit publik (këtu mund të jemi në rastin kur aplikantit i kthehet përgjigje për mosrikomisionim, për shkak se nuk përmbush kriteret ligjore / bio-psiko-sociale);
- Kërkohet rishikimi i rastit (në rastet kur kërkohet rivlerësim nga komisioni).

Për të njëjtën çështje, pala (ankimuesi) nuk mund të ushtrojë për së dyti mjete ligjore administrative.

- **Ankimi administrativ kundër një akti administrativ**

Akti administrativ mund të jetë individual ose kolektiv.

Akti administrativ është individual kur një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik shpreh vullnetin e tij ndaj një ose më shumë subjekteve të përcaktuara, duke krijuar, ndryshuar ose shuar një marrëdhënie juridike konkrete. Shprehja e vullnetit mund të kryhet në formë të shkruar në letër ose elektronike, verbale, ose çdo formë tjetër të përshtatshme, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligji.

Akti administrativ kolektiv, i drejtohet një grupi subjektesh, anëtarët e të cilit janë të përcaktuar individualisht ose mund të përcaktohen individualisht mbi bazën e karakteristikave të përgjithshme (nuk aplikohet në rastin konkret).

Pra, *akti administrativ*, quhet çdo urdhër, vendim, apo veprim që merret nga autoritetet administrative për rregullimin e një rasti të veçantë ose rasteve të përgjithshme në sferën e të drejtës publike.

Çfarë forme dhe përmbajtjeje duhet të ketë ankimi administrative?

Ankimi duhet të paraqitet me shkrim dhe duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

- Subjektin që ka paraqitur ankimin;

-
- Organin që do të shqyrtojë ankimin;
 - Aktin administrativ që kundërshtohet ose aktin administrativ që kërkohet të lëshohet, i cili nuk është nxjerrë;
 - Objektin dhe shkaqet për të cilat bëhet ankimi.

Emërtimi i dokumentit nuk është i rëndësishëm. Çdo kërkesë drejtuar organit publik vlerësohet si ankim administrativ, edhe nëse nuk mban këtë emër, për aq kohë sa qëllimi i ankimit shprehet qartë në të.

****DRSHSSH** njofton zyrtarisht aplikantin mbi vendimin e marrë nga KSHVAK. Në formatin zyrtar të njoftimit përcaktohet e drejta e ankimit dhe afatet brenda të cilit duhet të bëhet ankesa pranë komisionit të nivelit më të lartë, kur aplikanti përfitues ose jo, nuk është dakord me vendimin e marrë nga ky komision.

Cilat janë kushtet për pranimin e ankimit administrativ kundër një akti administrativ?

Ankimi kundër aktit administrativ apo mosnxjerrjes së tij është i pranueshëm nëse plotëson të gjitha këto kushte:

- Nuk është përjashtuar shprehimisht nga ligji;
- Ankuesi pretendon se të drejtat apo interesat e tij të ligjshme cenohen nga veprimi apo mosveprimi i organit publik dhe ky ankim nuk është kryer më parë për të njëjtën çështje;
- Është paraqitur brenda afatit;
- Plotëson çfarëdo kushti tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj.

Afati kohor brenda të cilit duhet kryer ankimi

Ankimi administrativ sipas Vendimit Nr.722, datë 11.11.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”, duhet të paraqitet brenda 20 ditëve nga data kur ankuesi ka marrë njoftim për nxjerrjen ose refuzimin e nxjerrjes së aktit administrativ.

Në rastin e mosveprimit të organit administrativ, me përjashtim të rasteve kur është i zbatueshëm miratimi në heshtje, ankimi paraqitet jo më parë se 7 ditë dhe jo më vonë se 45 ditë nga data kur ka përfunduar afati brenda të cilit organi administrativ duhet të vepronte.

Procedura e ankimit dhe efektet e saj

Kujt organi mund t'i drejtohet ankimi?

Për aq kohë sa nuk parashikohet ndryshe nga ligji, ankimi kundër një akti administrativ mund t'i drejtohet:

- Organit publik që ka nxjerrë ose ka kompetencë të nxjerrë aktin (në rastin konkret KSHVAK-së pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror DRSHSSH-së);
- Organit publik epror të organit që ka nxjerrë ose ka kompetencë të nxjerrë aktin (Komisionit të nivelit më të lartë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror DPSHSSH-së); ose
- Një organi tjetër publik të përcaktuar shprehimisht me ligj (në rastin konkret nuk aplikohet).

Cila është procedura e shqyrtimit të ankimit?

Kur organi publik kompetent (DRSHSSH / DPSHSSH) vlerëson se ankimi është i pranueshëm dhe plotësisht i bazuar, ai, me një akt të ri administrativ, anulon, shfuqizon ose ndryshon aktin administrativ, ose nxjerr aktin e refuzuar, siç është kërkuar nga ankuesi. Kjo nuk aplikohet për rastet që duhet të shqyrtohen / vlerësohen nga një komision i nivelit më të lartë, por mund të aplikohet në rastet kur psh., personit i është kthyer përgjigje zyrtarisht se nuk përmbush kriteret për vlerësim, dhe i është refuzuar e drejta e komisionimit. Këto raste dhe të tjera të ngjashme si këto kur ankimohen duhet të rishqyrtohen nga stafi i DRSHSSH-së.

Kur organi publik kompetent vlerëson se ankimi nuk është i pranueshëm dhe plotësisht i bazuar, e përcjell atë për shqyrtim dhe vendimmarrje tek organi epror, së bashku me të gjitha dokumentet përkatëse të dosjes dhe një raport me shkrim mbi qëndrimin e tij. Shkresa duhet të hartohet nga anetaret e komisionit pasi juristi nuk është pjesë e vendimmarrjes. Këtu mund të përfshihen rastet kur jemi jo vetëm përpara një ankimi për refuzim vlerësimi, por kryesisht në rastet kur jemi përpara një ankimi të vendimit të dhënë nga KSHVAK rajonal për aftësinë e kufizuar, përfshirë rastet e mëposhtme:

- Ankimimi i vendimit të KSHVAK kur shprehet se personi nuk përfiton;
- Ankimimi i vendimit për nivelin e përfitimit të aftësisë së kufizuar;
- Ankimimi i vendimit për dhënien e përfitimit të ndihmës personal;
- Ankimimi i vendimit për nivelin e dhënies së përfitimit të ndihmës personal;
- Ankimimi i vendimit për përfitime të tjera në shërbime, etj.

Komisioni i nivelit më të lartë në DPSHSSH refuzon ankimin nëse ai rezulton të jetë i papranueshëm apo i pabazuar. Refuzimi lëshohet me shkresë nga SHSSH, e cila në vetvete përbën një akt administrativ.

Nëse komisioni i nivelit më të lartë vlerëson se ankimi është i pranueshëm dhe i bazuar, ai vendos përfundimisht me anë të një vendimi I cili në vetvete përbën një akt administrative.

Ankimi për mosveprimin administrativ shqyrtohet drejtpërdrejt nga organi epror (DPSHSSH).

Brenda cilit afat duhet të njoftohet akti që vendos mbi ankimin?

Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, vendimi nxirret dhe i njoftohet ankuesit brenda 30 ditëve nga paraqitja e ankimit. Ky afat mund të zgjatet kur është e nevojshme kryerja e hetimeve administrative shtesë. Në këtë rast institucioni njofton zyrtarisht aplikantin.

Nëse ankuesi, person fizik apo juridik, vdes apo mbaron, gjatë zhvillimit të procedurës administrative, organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative, pa marrë një vendim përfundimtar për çështjen.

Efektet e ankimit

Cilat janë efektet e ankimit administrativ kundër një akti administrativ?

Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, ankimi administrativ pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Si përjashtim, zbatimi i aktit nuk pezullohet kur:

- akti administrativ synon mbledhjen e taksave, tatimeve dhe të ardhurave të tjera buxhetore;
- akti administrativ ka të bëjë me masa policore;
- organi publik, i cili shqyrton ankimin, vlerëson se zbatimi i menjëhershëm është në interes të rendit publik, shëndetit publik dhe të interesave të tjerë publikë.

Rastet e mospezullimit të aktit administrativ nuk aplikohen në këtë procedurë.

Megjithatë, rregulli i përgjithshëm është që kundër mospezullimit të aktit administrativ mund të bëhet ankim në gjykatën administrative, brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të vendimit për mospezullim.

Kundërshtimi Administrativ

Çfarë mund të kërkohet me kundërshtimin administrativ të një veprimi të organit publik?

Me anë të kundërshtimit administrativ ankuesi mund të kërkojë nga organi publik:

- ndalimin e kryerjes së një veprimi tjetër administrativ (psh. ndalimin e veprimit administrativ të ndërprerjes së përfitimit / dhënies së përfitimeve më të ulta, në rastet e rivlerësimit, apo kur kalohet nga skema e vjetër në skemën e re të vlerësimit bio-psiko-social, kur vendimi ankimohet në komisionin e nivelit më të lartë;

-
- kryerjen e një veprimi tjetër administrativ, për të cilin ankuesi ka të drejtë dhe e ka kërkuar, por organi publik nuk ka vepruar;
 - tërheqjen apo ndryshimin e një deklarate publike;
 - shpalljen të paligjshëm të një veprimi tjetër administrativ dhe ndreqjen e pasojave të shkaktuara prej tij.

Brenda cilit afat duhet të paraqitet kundërshtimi administrativ?

Kundërshtimi administrativ duhet të paraqitet brenda 15 ditëve nga data që ankuesi ka marrë dijeni për veprimin të cilin e kundërshton.

Çfarë forme dhe përmbajtjeje duhet të ketë kundërshtimi administrativ i një veprimi të organit publik?

Forma dhe përmbajtja e kundërshtimit administrativ është e njëjtë me atë të ankimit administrativ kundër një akti administrativ.

Brenda cilit afat duhet t'i njoftohet ankuesit vendimi i shqyrtimit të kundërshtimit administrativ?

Vendimi i shqyrtimit të kundërshtimit merret dhe i njoftohet ankuesit brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kundërshtimit.

Kundër vendimit mund të ngrihet padi e drejtpërdrejtë në gjykatën administrative.

Rishikimi

Çfarë është rishikimi dhe kur mund të kërkohet ai?

Rishikimi është mjete me anë të të cilit kërkohet anulimi apo ndryshimi i një akti administrativ të nxjerrë apo nxjerrja e një akti administrativ të refuzuar, kundër të cilit ankimi nuk është më i pranueshëm për shkak të kalimit të afatit brenda të cilit mund të bëhej.

Ankuesi mund të kërkojë rishikim, nëse zbulohen rrethana ose prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk dihen dhe nuk mund të dihen prej saj gjatë nxjerrjes së aktit administrativ.

Cili është afati brenda të cilit duhet të paraqitet kërkesa për rishikim?

Kërkesa për rishikim duhet të paraqitet brenda 30 ditëve nga dita që pala ka marrë dijeni për shkakun mbi të cilin e bazon atë, por në çdo rast jo më vonë se 2 vjet nga dita që ka lindur shkakun i rishikimit.

Ku dorëzohet kërkesa për rishikim?

Kërkesa për rishikim i dorëzohet organit që ka nxjerrë apo ka refuzuar të nxjerrë aktin administrativ që kërkohet të rishikohet.

Cili është vendimi që merret për rishikimin?

Organi të cilit i është drejtuar rishikimi mund të rrëzojë kërkesën për rishikim ose të anulojë apo të ndryshojë aktin e nxjerrë ose të nxjerrë aktin e refuzuar.

Ankimi në Gjykatë

Kur t'i drejtohem Gjykatës Administrative?

Çdo person i interesuar, i cili pretendon se i është shkelur, mohuar apo cenuar një e drejtë e ligjshme nga një organ i administratës publike, krahas ushtrimit të së drejtës së ankimit administrativ, mund të kërkojë mbrojtjen e të drejtave të tij edhe me anë të një mjeti tjetër ligjor, që është padia e cila ngrihet përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.

Si rregull, padia paraqitet pasi është ndjekur më parë rruga administrative. Për të ushtruar të drejtën e padisë, personi duhet të përpilojë vetë ose me ndihmën e një profesionisti, një kërkesë formale, e cila quhet kërkesëpadi.

Duhet pasur parasysh fakti që, kërkesëpadia duhet të ketë disa elementë, që janë parashikuar në ligjin "Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" dhe Kodin e Procedurës Civile, mosrespektimi i të cilave sjell mospranimin e saj nga gjykata.

Si ngrihet një padi në Gjykatën Administrative?

Si rregull, padia në gjykatë ndaj aktit ose veprimit administrativ mund të ngrihet vetëm pasi të jetë ndjekur më parë ankimi administrativ.

Përfshihen nga ky rregull rastet kur:

- ligji nuk parashikon organ më të lartë për paraqitjen e ankimit administrativ, ose kur organi më i lartë administrativ nuk është krijuar;
- ligji parashikon shprehimisht të drejtën për t'u ankuar ndaj veprimit administrativ drejtpërdrejt në gjykatë;
- organi më i lartë në shqyrtimin e një ankimi administrativ ka cenuar, me vendimin e tij, të drejtat apo interesat personale të ligjshëm të një personi, i cili nuk ka qenë palë në procedurën administrative.

Afati për ngritjen e padisë në gjykatë

Cilat janë afatet për ngritjen e padisë në gjykatën administrative?

Padia kundër aktit, veprimit, apo mosveprimit administrativ paraqitet në gjykatë brenda 45 ditëve. Ky afat fillon nga:

- ✓ Data e njoftimit, të aktit administrativ të komisionit të nivelit më të lartë, që ka shqyrtuar ankimin administrativ;
- ✓ Data e njoftimit, të aktit administrativ, në rastet kur ky akt ankimohet drejtpërdrejt në gjykatë;
- ✓ Data e botimit të aktit administrativ, në rastet kur ligji parashikon detyrimin për botimin e aktit (nuk aplikohet në rastin konkret);
- ✓ Data e marrjes dijeni për ndërhyrjen e paligjshme të organit publik mbi të drejtat dhe interesat ligjorë të subjektit, me çdo lloj veprimi që nuk plotëson kushtet dhe formën e aktit administrativ;
- ✓ Data e mbarimit të afatit ligjor brenda të cilit duhet të ishte nxjerrë akti administrativ;
- ✓ Data e mbarimit të afatit ligjor për shqyrtimin e ankimit administrativ, në rastet e mosveprimit të organit më të lartë administrativ.

Në rastet kur akti administrativ nuk përcakton qartë të drejtën e palës për të kundërshtuar aktin administrativ në gjykatë, nëpërmjet padisë, dhe afatin brenda të cilit mund të ngrihet padia, ligji për gjykatat administrative parashikon që afati i ngritjes së padisë është një vit.

Në rastin e mosparaqitjes së padisë brenda 1 viti, për arsye se udhëzimet në aktin administrativ nuk japin informacion të saktë për të drejtën e padisë, padia paraqitet edhe pas 1 viti, por në çdo rast, jo më vonë se 30 ditë nga data kur paditësi ka marrë dijeni për ekzistencën e së drejtës së padisë dhe vetëm kur paditësi jep shpjegime të besueshme për ekzistencën e këtyre rrethanave.

Afatet e mësipërme janë të pandryshueshme dhe shkelja e tyre shkakton humbjen e së drejtës së padisë.

Paditë për mosmarrëveshjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë, që rrjedhin nga pagesa e aftësisë së kufizuar, përveç sa është parashikuar në këtë ligj, shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin ku paditësi ka banimin ose vendqëndrimin.

A mund të ankimohet vendimi i gjykatës administrative të shkallës së parë

Nuk lejohet ankim ndaj vendimeve përfundimtare të gjykatës administrative për padi me objekt mosmarrëveshjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë, që rrjedhin nga pagesa e aftësisë së kufizuar, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi. Kur vlera e përlllogaritur e tejkalon këtë masë mund të bëhet ankim në gjykatën administrative të apelit, por jo në gjykatën e lartë.

Strukturat e ankimimit në Shërbimin Social Shtetëror

Për shqyrtimin në afat të ankesave, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror ngrihet dhe funksionon komisioni qendror i përbërë nga 3 antarë (që kanë në përbërje mjek dhe punonjës social). Ky komision asistohet edhe nga juristi i institucionit.

Juristi mbështet veprimtarinë procedurale dhe ligjore të komisionit si dhe mban përgjegjësi për ruajtjen e kofidencialitetit, mbi të dhënat personale të ankimuesve, për të cilat ai ka marrë dijeni gjatë ushtrimit të funksionit të tyre, mbi procesin e vlerësimit paraprak dhe të marrjes së vendimit.

Anëtarët e Komisionit janë staf në varësi të Shërbimit Social Shtetëror dhe ushtrojnë funksionet e tyre për:

- a. Shqyrtimin dhe zgjidhjen e kërkesave të subjekteve që ankimojnë vendimet e komisioneve shumëdisiplinore të nivelit rajonal;
- b. Studimin dhe vlerësimin para dhe gjatë zhvillimit të seancës së dokumentacionit të dosjes dhe në raste të caktuara kërkon ekzaminime të specializuara, përveç atyre të parashikuara në dosje;
- c. Caktimin e nivelit të aftësisë së kufizuar, ndihmesës personale dhe përfitimeve të tjera në pagesa e në natyrë;
- d. Shqyrtimin e ankesave të subjekteve që pretendojnë që i është shkelur e drejta e komisionimit nga komisioni në nivel rajonal;
- e. Kryerjen e studimeve mbi gjendjen dhe ecurinë e aftësisë së kufizuar, përcaktimin e udhëzimeve dhe zgjidhjet për përmirësimin e treguesve përkatës;

Aplikuesi ka të drejtën e ankimimit për procedurën e vlerësimit në rastet e refuzimit të kërkesës / aplikimit për përfitime për shkak të aftësisë së kufizuar.

Ankimimi bëhet me shkrim brenda 20 (njëzetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror.

Shqyrtimi realizohet dhe i njoftohet ankimuesit brenda 30 ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së ankesës.

Në rastet kur kërkesa pranohet, personit do t'i lindë e drejta e marrjes së përfitimeve që nga muaji pasardhës nga data e marrjes së vendimit nga komisioni shumëdisiplinor në nivel rajonal ose sipas përcaktimeve në vendimin e gjykatës.

Vendimi i Komisionit arkivohet në dosjen përkatëse dhe hidhet në Regjistrin Elektronik Kombëtar.

Nëse ankimuesit refuzojnë të kryejnë ekzaminimet e kërkuara Komisioni merr vendim negativ, dhe dosja i kthehet Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror. Në këtë rast dosja konsiderohet e mbyllur dhe për rihapjen e saj do të ndiqet procedura si për rastet që paraqiten për vlerësim për herë të parë.

Komisioni i shqyrtimit të ankesave nuk mund të marrë në rishqyrtim rastet për të cilat ai është shprehur një herë (res judicata), rastet kur ankimuesi ka të njëjtën gjendje apo aftësi të kufizuar, me

përrjashtim të rasteve kur ankuesi ka kërkuar rishikim, për shkak se janë zbuluar rrethana ose prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk dihen dhe nuk mund të dihen gjatë nxjerrjes së aktit administrativ.

Mjeku dhe punonjësi social i komisionit të shqyrtimit të ankesave, gjatë ushtrimit të detyrës së tij në komision, nuk mund të jetë pjesë e vendimmarrjes në komisionet shumëdisiplinore të aftësisë së kufizuar që kanë vlerësuar rastin dhe as pjesëmarrës në procesin e referimit për vlerësim të personave me aftësi të kufizuara (në këtë rast mjeku), pasi kjo do të përbënte konflikt interesi.

Mbledhjet e komisionit të shqyrtimit të ankesave organizohen dhe drejtohen nga kryetari i komisionit, i cili kryen edhe detyra e përgjegjësi të tjera të ngjashme me ato të anëtarëve të komisionit.

Marrja e vendimit bëhet me votim, ku në rastet kur anëtarët kanë mendime të kundërta, vendimi merr formën e prerë me shumicë votash.

Vendimi i organit epror (komisionit të shqyrtimit të ankesave) nuk mund të ndryshohet nga KSHVAK në nivel rajonal.

Në ato raste kur KSHVAK-ja e nivelit rajonal gjykon se kërkuesi paraqet gjendje shëndetësore të rënduar dhe bën objekt për të ndryshuar kushtet e përfitimit, ai merr vendim duke argumentuar edhe arsyen e këtij ndryshimi. Në këto raste, pavarësisht vendimit të KSHVAK-së së nivelit rajonal, vendimi do të hyjë në fuqi vetëm pas miratimit të komisionit të shqyrtimit të ankesave.

Procedura e shqyrtimit të ankesave nga komisioni i nivelit më të lartë realizohet përmes Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të PAK, realizohet sikurse paraqitet në skemën më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, nëpërmjet strukturës përgjegjëse për kontrollin e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar, kontrollon dhe monitoron procedurat e ankimit dhe bën pjesë të raportit vjetor rezultatet e tij, të cilat ndër të tjera duhet të përmbajnë edhe:

- (i) Numrin e ankesave të mbledhura (mujore, tremujore, vjetore);
- (ii) Numrin e ankesave, sipas statusit të zgjidhjes (të hapura, të referuara, të mbyllura);
- (iii) Numrin dhe përqindjen e ankesave të zgjidhura brenda kornizës kohore të përcaktuar;

Raportet vjetore të SHSSH publikohen në faqen zyrtare të institucionit dhe janë të aksesueshme për publikun.

* *

*